



ANRD

ALBANIAN NETWORK FOR RURAL DEVELOPMENT

RRJETI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural

info@anrd.al; www.anrd.al

Hyrje

Ky dokument synon të hedhë dritë mbi panoramën ekzistuese të zhvillimit rural me pjesëmarrje, aktorët kryesorë, rolin, kapacitetet dhe pozicionimin e tyre në lidhje me zbatimin e qasjes LEADER+. Ai prezanton gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet kryesore nga një seri aktivitete të organizuara nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) me përfshirjen e aktorëve publikë dhe jopublikë, në nivel kombëtar dhe rajonal në periudhën mars-maj 2016.

Perspektiva që Rrjeti ndau me aktorët në nivel kombëtar dhe rajonal/lokal thekson rëndësinë e përfshirjes së aktorëve jopublik në axhendën kombëtare për zhvillimin rural, qasjen ndërsektoriale dhe shumëaktorësh që zhvillimi rural kërkon si dhe zhvillimin nga poshtë-lart, që përbën edhe perspektivën themeluese të Rrjetit. Konferenca dhe tryezat rajonale, ofruan mundësinë për të realizuar një vlerësim paraprak të aktorëve kryesorë dhe kapaciteteve të tyre, si dhe pozicionimin e tyre për të kontribuar në zhvillimin rural, specifikisht në zbatimin e qasjes LEADER, komponent i rëndësishëm i Strategjisë Ndërsektoriale të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2020 dhe programit IPARD.

Konferenca lançuese u mundësua nga Fondacioni Friedrich Ebert (FES). Ndërsa aktivitete rajonale u bënë të mundur nëpërmjet mbështetjes së Komisionit Europian¹, dhe organizatave anëtare të Rrjetit (CESVI, AGRINET, VIS Albania dhe AGROPUKA). Vlen të përmendet edhe mbështetja dhe pjesëmarrja aktive në këto aktivitete e

11 Mars 2016 - Konferenca lançuese e Rrjetit;

04 maj 2016 – Tryeza rajonale Fier (qarqet Berat, Gjirokastrë, Fier, Vlorë);

12 maj 2016 – Tryeza rajonale Pogradec (qarqet Elbasan dhe Korçë)

18 maj 2016 – Tryezë rajonale Shkodër (qarqet Dibër, Lezhë, Kukës dhe Shkodër)

Pjesëmarrës: përfaqësues nga këshillat e qarqeve, bashkitë, drejtoritë rajonale të bujqësisë; drejtoritë arsimore rajonale dhe të shëndetit, agjencitë e zhvillimit rajonal; shoqata dhe federata fermerësh; përfaqësues të shoqërisë civile (shoqata të grave, të rinjve, mjedisore, ato që promovojnë demokracinë lokale dhe zhvillimin lokal me pjesëmarrje, zhvillimit rural, turizmi etj), të grupeve me bazë komunitare formale dhe informale të sektorit privat (agro-biznesi, bankat) si dhe profesionistë dhe individë aktiv të interesuar.

¹ Mbështetja e KE është mundësuar nëpërmjet projektit ALTER – Active Local Territories for Economic Development of Rural Areas, që zbatohet nga konsorcium i rrjeteve rurale të vendeve të Ballkanit dhe Turqisë si dhe PREPARE (Partnership for Rural Europe). IDM është organizata partnere për Shqipërinë që vepron në emër të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.

Drejtorisë së Politikave të Zhvillimit Rural, dhe Autoritetit Menaxhues në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Adminisrimit të Ujërave (MBZHRAU).

Konteksti

Anëtarësimi në BE përfaqëson një objektiv strategjik të vendit dhe agjenda e integritit europian udhëheq rrugëtimin zhvillimor të Shqipërisë. Perspektiva e anëtarësimit në BE reflektohet në strategjitë e ndryshme të vendit, duke veçuar këtu Strategjinë Ndërsektoriale të Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (SNZHRB) e hartuar në harmoni me parimet kryesore të politikave të ardhshme të BE-së, PPB-në (Politika e Përbashkët Bujqësore) dhe politikat e paraaderimit (IPARD), duke qenë njëkohësisht relevante edhe me specifikat e sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale në Shqipëri.

Strategjia Ndërsektoriale njeh dhe thekson rolin që zhvillimi rural luan në ristrukturimin e sektorëve të bujqësisë dhe agropërpunimit, nëpërmjet mbështetjes për krijimin e aktiviteteve ekonomike alternative dhe mundësive për vende pune. Për shkak të mundësisë që ofron për ristrukturim, fuqizimi shihet te nismat lokale, me qasje nga poshtë-lart dhe pjesëmarrjet lokale në planifikimin dhe zhvillimin në nivel lokal nëpërmjet Grupet Lokale të Veprimit (GLV).²

Përgatitja dhe zbatimi i strategjive lokale për zhvillimin rural – Qasja "Leader" – si një masë që do të financohet nga instrumenti i financimit IPARD II, përfaqëson një përmbysje të politikave të deritanishme të zhvillimeve lokale me qëllim forcimin e demokracisë lokale nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së popullsisë rurale dhe zhvillimit të shoqërisë civile si dhe dialogut social brenda popullsisë rurale, lehtësimit të qeverisjes së mirë përmes partneriteteve lokale dhe nxitjes së punësimit dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor. Kërkesat dhe implikimet që parashtrojnë zbatimi i qasjes Leader përbëjnë perspektivën themeluese të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural, duke e vendosur kështu Rrjetin në pararojë të zhvillimit rural me pjesëmarrje në Shqipëri.

Zbatimi i SNBZHR dhe në veçanti i masës *"Përgatitja dhe zbatimi i strategjive lokale për zhvillimin rural – Qasja "Leader"* nuk do të jetë e lehtë, duke marrë parasysh kërkesat që parashtrojnë kjo qasje dhe sfidave që realiteti shqiptar ofron në zhvillimin rural. Prezantimi i sfidave më poshtë është bërë në formën e gjetjeve dhe konkluzioneve të identifikuara nga aktivitetet me pjesëmarrjen e aktorëve të zhvillimit rural nga të dy sektorët, publik dhe jopublik.

Sfidat e zhvillimit rural

Të kuptuarit se zhvillimi rural është një qasje ndërsektoriale dhe përfshin shumë aktorë është një nga sfidat fillestare për zbatueshmërinë e strategjisë. Fryma dhe vizioni ndërsektorial i zhvillimit bujqësor dhe rural duhet të përfshijë të gjitha institucionet në të gjitha nivelet, që nga institucionet qendrore deri te ato në nivel rajonal e lokal, duke nisur nga Drejtoritë e Bujqësisë dhe gjithë drejtoritë e sektorëve të ndryshëm si në edukim, shëndetësi etj.

² Strategjia Ndërsektoriale e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2014-2020)

Fakti që SNZHRB përshkohet nga një frymë ndërsektoriale, me struktura si Grupi ndërministror i punës i krijuar për koordinimin e përgatitjeve të kësaj strategjie, apo Komiteti i Monitorimit të IPARD reflekton përprojetet për të ndarë vizionin ndërsektorial të zhvillimit rural. Megjithatë, pavarësisht këtyre, në aktivitete u identifikua një prani e ulët e aktorëve të interesit që nuk operojnë në sektorin bujqësor, por që luajnë rolin e tyre në sektorë të ndryshëm të zhvillimit rural, si edukimi, shëndetësia, turizmi, kultura, etj.

Ende nuk ka një kuptim të përbashkët ndërmjet aktorëve të ndryshëm mbi atë se çfarë është zhvillimi rural; perceptimi i zhvillimit rural si qasje ndërsektoriale dhe që përshin shumë aktorë vazhdon të jetë i ulët. Ka nevojë të ndahet dhe të arrihet një mendësi me të gjithë aktorët e interesit rreth zhvillimit rural – që përfshin gjithçka që synon përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe mirëqenien ekonomike të njerëzve që jetojnë në zonat relativisht të izoluara dhe pak të populluara. Kjo mendësi të jetë e pranishme te të gjithë aktorët e interesit – në sektorin publik dhe jopublik (shoqëria civile, universitetet, profesionistët dhe biznesi, etj).

Të ndarit e një kuptimi të përbashkët rreth zhvillimit rural ka avantazhin se ndihmon aktorët e interesit të identifikojnë dhe të artikulojnë më mirë rolin e tyre në këtë sipërmarrje. Si rrjedhim, edhe përfshirja e tyre do të jetë konkrete në avancimin e agjendës së zhvillimit rural. MBZHRAU si institucioni kryesor duhet të ndajë një vizion më të qartë dhe më të gjerë të zhvillimit bujqësor dhe rural.

Në të vërtetë, zhvillimi ndodh në nivel lokal

Rëndësia e lokalizimit të agjendës zhvillimore duke përfshirë të gjitha nivelet e qeverisjes ka qenë një nga mësimet e nxjerra nga komuniteti ndërkombëtar bazuar në zbatimin e objektivave të zhvillimit të mijëvjeçarit (MDGs) gjatë procesit pas 2015. Një seri deklaratash dhe agjendash në nivel global³ kanë venë theksin në rolin e qeverisjes lokale në përmirësimin e demokracisë, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes. Ndërkohë deklaratat më të fundit (the New Agenda 2030, si dhe Addis Ababa Action Agenda)⁴ e konsiderojnë nivelin lokal si esencial për zhvillimin në të gjitha nivelet.

61 bashkitë që tashmë përfaqësojnë nivelin e parë të qeverisjes luajnë një rol të rëndësishëm në mundësimin e zhvillimit lokal, ofrimin e shërbimeve publike bazë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët. Bashkitë përfaqësojnë qeverisjen më pranë qytetarëve dhe nevojave të tyre dhe kanë një kuptim më të mirë të problemeve. Ato harmonizojnë politikat kombëtare me prioritetet lokale zhvillimore. Bashkitë përfaqësojnë autoritetet publike në pozitën më të mirë për të nxitur zhvillimin në nivel lokal, aty ku zhvillimi ndodh vërtet.

Rëndësinë e aktorëve në nivel lokal në zhvillimin bujqësor dhe rural e transmeton edhe SNZHBR, ku për zbatimin e saj kërkohet bashkëpunim i ngushtë me autoritetet lokale, organizatat përkatëse që operojnë në nivel lokal dhe bizneset lokale. Edhe pse zhvillimi ekonomik lokal është funksion ekskluziv i bashkive dhe ka pritshmëri të larta rreth rolit të bashkive për zhvillimin lokal socio-ekonomik (veçanërisht tani pas reformës administrative territoriale) ato gjenden realisht të papërgatitura për zhvillimin rural dhe adresimin

3 Rio +20 Declaration 2012 http://www.un.org/disabilities/documents/rio20_outcome_document_complete.pdf; Busan Partnership for Effective Development Co-Operation 2011 <http://www.oecd.org/dac/effectiveness/49650173.pdf>

4 Transforming our world: the 2030 Agenda for Sustainable Development <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20%20%20eb.pdf>
Addis Ababa Action Agenda 2015: http://www.un.org/esa/ffd/wp-content/uploads/2015/08/AAAA_Outcome.pdf

e nevojave dhe problematikave që komunitetet rurale manifestojnë. Reforma administrative-territoriale dhe thellimi më tej i decentralizimit teorikisht janë argumenta ndihmës për zhvillimin rural nga bashkitë e reja. Megjithatë, në praktikë, këto reforma duhet të mundësojnë zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme të qeverisjes lokale për të përmbushur funksionet e caktuara, si dhe krijimin e një mjedisi mundësues për zhvillimin lokal. Nevojiten përpjekje sistematike dhe të organizuara nga institucionet qendrore si parakusht i përgatitjes së bashkive për mundësimin e zhvillimit të udhëhequr nga komuniteti, zbatimit të qasjes LEADER ku qeverisja lokale angazhohet në partneritet me shoqëri civile dhe biznesin.

Shoqëria civile dhe zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti

Shoqëria civile përfaqëson një grup interesi të rëndësishëm për zhvillimin rural dhe një nga aktorët e partneritetit tripalësh (ndërmjet shoqërisë civile, aktorëve publik dhe sektorit privat) që karakterizon Grupet Lokale të Veprimit. Pavarësisht progresit të përgjithshëm të shoqërisë civile në vendin tonë, në zonat rurale ky sektor është ende i pazhvilluar dhe i kufizuar në numër dhe kapacitete njerëzore. Një shoqëri civile e pazhvilluar përjashton komunitetet lokale të përfitojnë nga avantazhet e mirëqeverisjes, pasi qeverisja lokale funksionon në mungesë të presioneve dhe influencës që vetëm shoqëria civile aktive mund të ushtrojë.

Fuqizimi i shoqërisë civile dhe i gjithë sektorit jopublik përbën prioritet për të mundësuar zhvillimin me qasje nga poshtë-lart, zhvillimi që ndodh nga vetë komunitetet rurale. Partneriteti i GLV paraqet alternativën e provuar dhe të suksesshme të zhvillimit rural – një partneritet që duhet të kthehet në pjesë të strukturës sociale dhe institucionale të komuniteteve rurale duke paraqitur kështu formën fundore dhe kulmore të zhvillimit lokal. Megjithatë ka ende shumë punë në të gjitha nivelet.

Pavarësisht gamës së problematikave në vend në lidhje me sektorin e shoqërisë civile, gjetjet paraprake nga tryezat rajonale janë optimiste rreth potencialeve që ky sektor ofron për zhvillimin rural nëpërmjet zbatimit të qasjes LEADER. Tryezat në nivel rajonal identifikuan ekzistencën e kapaciteteve, përvojave dhe investimeve të ndryshme nga shoqëria civile në bujqësi, agro-turizëm (promovimi, krijimi dhe funksionimi i fermave, klasterave si dhe grupeve të prodhuesve), promovimin e territorit, trashëgimisë kulturore, mjedisit etj. Aktualisht, mund të thuhet se shoqëria civile përbën pjesën më vitale dhe më dinamike të zhvillimit rural. Eksperienca të suksesshme të zhvillimit rural që vijnë nga CESVI, VIS Albania, AgroPuka, Agrinet e shumë organizata të tjera që punojnë në nivel lokal, dëshmojnë për kapacitetet dhe potencialin e madh që ka shoqëria civile për të sjellë ndryshime në jetët e banorëve të komuniteteve rurale. Për më tepër, ndër vite është investuar në kapacitete njerëzore nga programe të ndryshme të zhvillimit rural. Këto kapacitete janë potenciale që çdo komunitet duhet të njohë dhe promovojë për të luajtur rolin e agjentit të zhvillimit.

Këto kapacitete dhe potenciale (organizata dhe individë) krijojnë motivimin e duhur për të promovuar zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti ku agjent i ndryshimit në nivel lokal është vetë shoqëria civile.

Këto bërthama të identikuara dhe të tjera si këto përfaqësojnë praktika mbi të cilat mund të investohet dhe ndërtohen përpjekje të mëtejshme në kuadër të zbatimit të qasjes LEADER+ dhe përfshirjes në Planet e Zhvillimit Vendor të Grupeve Lokale të Veprimit.

Rekomandime

1. Kuadri rregullator për ngritjen dhe funksionimin e GLV-ve

Kuadri rregullator aktual nuk lehtëson krijimin dhe organizimin e një modeli funksionues të grupeve lokale të veprimit. Një kuadër rregullator funksional do t'i jepte shtysën nismave pioniere të partneriteteve të ngjashme. MBZHRAU duhet të udhëheqë procesin e hartimit të një kuadri rregullator rreth krijimit dhe funksionimit të GLV-ve.

2 Krijimi i forumeve shumëaktorësh mbi zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti në nivel lokal dhe rajonal

Duke marrë në konsideratë sfidat për zbatimin e SNZHBR, duhet të ekzistojnë hapësira me aktorët e zhvillimit lokal për diskutim, informim, konsultim, ngritje kapacitetesh, transferim njohurish, rjetëzim dhe ndarje eksperiencash. Këto hapësira mund të marrin formën e forumeve jo-formale, shumëaktorësh që shërbejnë si mekanizëm për të zbritur strategjinë në nivel lokal dhe për për ta jetësuar më lehtë dhe natyrshëm. Forumet “Europa në Shqipërinë Rurale” mund të jenë një instrument ndryshimi.

Rjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) - një nismë e shoqërisë civile për të promovuar dhe jetësuar zhvillimin rural të udhëhequr nga komuniteti nëpërmjet advokacisë dhe nismave në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të qëndrueshëm rural me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës të komuniteteve rurale në Shqipëri - u formalizua në fund të vitit 2015 duke kurorëzuar një seri përpjekjesh ndër vite. Rjeti shënoi edhe rjetin e fundit të krijuar në vendet e Ballkanit në vazhdën e zgjerimit të lëvizjes mbarë-europiane për zhvillim rural.